



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 305/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA për shkak të vendosjes së banerit në afërsi të shkollës në Kaçanik, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr 305/2017 e datës 14.06.2017 parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN),

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), në të cilën thekson se në afërsi të shkollës së mesme “Skenderbeu” në Kaçanik, konkretisht pran qendrës së votimit 0701D, në ditën e zgjedhjeve monitoruesit e tyre kane hasur në një poster reklamues të kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këto veprime është shkelur neni 36 i LZP-së, pasi që posteri gjendej në afërsi prej 100 metrave afër shkollës, dhe si dëshmi lidhur me shkeljen e pretenduar ka bashkangjitur një foto.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse

dhe të qartë se është shkolla e mesme “Skenderbeu” dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 305/2017 më datën 14.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.